



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Gjeografi bërthamë

Varianti B

Udhëzime të përgjithshme

- Testi përmban në total 40 pikë
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

• *Pyetjet me zgjedhje*

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	D	B	C	D	D	A	C	A	D	A

• *Pyetjet me zhvillim*

Pyetja 11

Model përgjigjeje:

*Një ndryshim midis **detit** Adriatik e Jon:*

- Deti Adriatik ka tejdukshmëri më të ulët se deti Jon
- Deti Adriatik ka kripësi më të ulët se deti Jon
- Deti Adriatik ka thellësi më të ulët

*Dy ndryshime midis **bregdetit** Adriatik e Jon:*

- Bregdeti i Adriatikut është i tipit të ulët, ranor, ndërsa ai i Jonit është i tipit të lartë shkëmbor
- Bregdeti i Adriatikut është i tipit të grumbullimit, ndërsa ai i Jonit është i tipit gërryes
- Bregdeti i adriatikut kryesisht përparon në drejtim të detit, ndërsa ai i Jonit tërhiqet
- Bregdeti i Adriatikut dallohet për plazhe ranore, ndërsa ai i Jonit për plazhe zallore

3 pikë nëse jep një ndryshim të **detit** Adriatik dhe Jon dhe dy ndryshime të **bregdetit** të tyre
OSE

2 pikë nëse jep një ndryshim të **detit** Adriatik dhe Jon dhe një ndryshim të **bregdetit** të tyre **OSE**
vetëm dy ndryshime midis bregdeteve

1 pikë nëse jep një ndryshim të **detit** Adriatik dhe Jon **OSE** një ndryshim të **bregdetit** të tyre

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

Pyetja 12**Model përgjigjeje:**

- a) Shtrihet në qendër të Alpeve
- b) Ka reliev të lartë, të ashpër e të thepisur
- c) Ka lugje akullnajore, gropa karstike e bimësi shumë e pakët
- d) Maja më e lartë është 2694m

3 pikë nëse jep tri karakteristika fiziko-natyrore të Bllokut të Jezercës

OSE

2 pikë nëse jep dy nga karakteristika fiziko-natyrore të Bllokut të Jezercës

1 pikë nëse jep një nga karakteristika fiziko-natyrore të Bllokut të Jezercës

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

Pyetja 13**Model përgjigjeje:**

- a) Ultësira e Shkodrës
- b) Fusha midis Lezhës dhe Shkumbinit
- c) Kodrat e Kërrabës
- d) Fusha e Elbasanit
- e) Plaja e Dumre – Darsisë
- f) Kodrat e Mallakastrës
- g) Fusha e Myzeqesë

3 pikë nëse jep tri nga njësitë përbërëse të Rajonit Perëndimor

OSE

2 pikë nëse jep dy nga njësitë përbërëse të Rajonit Perëndimor

1 pikë nëse jep një nga njësitë përbërëse të Rajonit Perëndimor

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

Pyetja 14**Model përgjigjeje:**

Popullsia në trevat shqiptare përgjithësisht është homogjene. Në Shqipëri 98% e zë popullsia shqiptare dhe vetëm 2% e zënë pakicat kombëtare (greke, maqedonase, malazeze)

2 pikë nëse përcakton që popullsia është homogjene dhe jep raportin e saktë

OSE

1 pikë nëse përcakton që popullsia është homogjene **OSE** jep raportin e saktë

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

Pyetja 15**Model përgjigjeje**

a) Shpërbërja e lavës vullkanike, pluhuri dhe hiri vullkanik e bëjnë tokën mjaft pjellore.

1 pikë Nëse bën argumentim të plotë

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

Model përgjigjeje:

b) Produktet e ngurta mund të shfrytëzohen si minerale të dobishme, materiale ndërtimi mjaft të forta, materiale zjarrduruëse

Avujt e ujit dhe gazet gjatë dukurive postvullkanike, shfrytëzohen për prodhimin e energjisë elektrike

2 pikë nëse rendit dy nga mënyrat se si mund të shfrytëzohen produktet vullkanike

OSE

- 1 pikë** nëse rendit një nga mënyrat se si mund të shfrytëzohen produktet vullkanike
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare
-

Pyetja 16**Model përgjigjeje:**

Pozicioni gjeografik mund të shprehet në dy mënyra:

Pozicion gjeografik absolut

Pozicion gjeografik relativ

Shpjegimi i njërës prej tyre

Pozicion gjeografik absolut – që jep pozicionin e saktë të një vendi mbi bazën e koordinatave gjeografike

Pozicion gjeografik relativ – që jep pozicionin e një vendi në raport me një vend tjetër.

- 3 pikë** nëse përcakton pozicionin gjeografik absolute dhe relativ dhe shpjegon njërin prej tyre

OSE

- 2 pikë** nëse bën vetëm përcaktimin e pozicionit absolute dhe relativ
2 pikë nëse përcakton dy nga mënyrat dhe bën shpjegimin e njërit prej tyre
1 pikë nëse përcakton një nga mënyrat, ose shpjegon njërin prej tyre
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare
-

Pyetja 17**Model përgjigjeje:**

Liqenet karstikë janë formuar nga tretja e gëlqerorëve dhe e gipseve.

Ushqehen kryesisht nga reshjet e shiut.

Gjenden në pllajën e Dumresë.

- 3 pikë** nëse përcakton si formohen liqenet, nga se ushqehen dhe ku gjenden

OSE

- 2 pikë** nëse i përgjigjet dy nga të mësipërmet
1 pikë nëse i përgjigjet vetëm një nga të mësipërmet
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare
-

Pyetja 18**Model përgjigjeje:**

Tipi i grykëderdhjes: në formë estuari (hinke)

Formohet kur detet janë të thellë

Kur maretë janë të fuqishme dhe heqin depozitimet që sjell lumi

- 3 pikë** nëse përcakton tipin e grykëderdhjes dhe bën një argumentim të plotë

OSE

- 2 pikë** nëse përcakton tipin e grykëderdhjes dhe bën argumentim të pjësshmëm
1 pikë nëse përcakton tipin e grykëderdhjes **OSE** bën argumentim të pjësshmëm
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare
-

Pyetja 19**Model përgjigjeje**

- Lejimi i lëvizjes se lire të njerëzve pas viteve 1990
- Prirja e largimit të popullsisë nga rajonet e larta malore drejt zonave fushore dhe qyteteve kryesore
- Kërkesa për kushte më të mira pune dhe banimi

3 pikë nëse analizon tri faktorë që kanë ndikuar në rritjen e popullsisë së rajonit

OSE

2 pikë nëse analizon dy nga faktorët

1 pikë nëse analizon një nga faktorët

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

Pyetja 20**Model përgjigjeje:**

Gjejmë sa është ndryshimi i gjatësisë midis gjatësisë gjeografike midis Ankarasë dhe Tiranës.

$$33^{\circ} - 20^{\circ} = 13^{\circ}$$

$$24 \text{ h} \longrightarrow 360^{\circ}$$

$$1 \text{ h} \longrightarrow 15'$$

$$X = 360 * 1 / 24 = 15^{\circ}$$

Toka për 1 orë (60') rrotullohet 15° , gjejmë sa minuta i duhen asaj për që të rrotullohet 1° .

$$60 \text{ min} \longrightarrow 15^{\circ}$$

$$X \text{ min} \longrightarrow 1^{\circ}$$

$$X = 60 * 1 / 15 = 4 \text{ minuta}$$

Për 4min Toka rrotullohet 1° , gjejmë sa minuta i duhen asaj që të rrotullohet 13° .

Kështu:

$$\text{Për } 4 \text{ min} \longrightarrow 1^{\circ}$$

$$\text{Për } X \text{ min} \longrightarrow 13^{\circ}$$

$$X = 13 * 4 / 1 = 52 \text{ min}$$

Pra ndryshimi midis kohës lokale të Ankarasë dhe Tiranës është 52min.

Koha lokale e Ankarasë është $13\text{h}05' + 52' = 13\text{h}57'$

4 pikë nëse bën një zgjidhje të plotë të ushtrimit.

OSE

3 pikë nëse gjen ndryshimin midis gjatësisë gjeografike të Ankarasë dhe Tiranës, gjen se për sa minuta rrotullohet Toka për 1° dhe gjen në minuta ndryshimin në grade të gjatësisë gjeografike midis Ankarasë dhe Tiranës

2 pikë nëse gjen nëse gjen ndryshimin midis gjatësisë gjeografike të Ankarasë dhe Tiranës, gjen se për sa minuta rrotullohet Toka për 1°

1 pikë nëse gjen nëse gjen ndryshimin midis gjatësisë gjeografike të Ankarasë dhe Tiranës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare